



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL Anr. 354/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fikrije Mekolli nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, paraqitur për shkak të parregullsive në numërimin e votave nga komisionarët dhe vëzhguesit e këtij subjekti politik, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa ZL A.nr 354/2017 e datës 23.10.2017 e parashtruar nga Fikrije Mekolli kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë, për shkak të parregullsive në numërimin e votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Fikrije Mekolli nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Fushë Kosovë në të cilën pretendohet se i janë vjedhur votat e saja pasi që pasi që nga numërimi i votave del se ajo i ka 47 vota dhe se i mungojnë edhe votat e familjareve të saj. E njëjta dyshon se komisionarët dhe vëzhguesit e PDK i kanë vjedhur votat dhe kërkon nga PZAP-i që të behet rinumërimi i votave

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në Komunën e Fushë Kosovës, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen

e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Fikrije Mekolli, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL Anr. 354/2017 më datën 24.10.2017



**Kryesuesi / Panelit**  
**Zyhej Flaziri**

*Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*